

**AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"MiA Collection" shpk**

Sot, më 24.02.2025, ne, themeluesit,

- a) **Sonila Abdalli**, atësia Sokol, shtetase Shqiptare, e datëlindjes 24.06.1989, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë; madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e identifikuar me anë të ID me numër personal: I95624051B.
- b) **Bledar Këneta**, atësia Selman, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 06.12.1984, lindur në Shijak dhe banues në Tiranë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me anë të pasaportës me numër personal: I41206005V.

kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtme.

**Neni 1
Themelimi**

- 1) Emri i shoqërisë është **"MiA Collection" shpk**.
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2:
Objekti**

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:
 - a) Konservim, Promovim, Ekspozim, Shitje e koleksioneve të produkteve Made in Albania (Prodhur në Shqipëri) dhe vintage gift shop (shitblerje objekteve, paisjesh dhe produkteve të vjetra). Çdo aktivitet tjetër të ligjshëm sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi.

**Neni 3:
Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4:
Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Njësia Bashkiake nr.9, "Bulevardi Zogu I", Ndërtesë Nr.24/2, Kati 2, Z.K 8360, Tiranë.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

**Neni 5
Kapitali themeltar**

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10 000 (dhjetë mijë) Lekë dhe është i ndarë në 2 (dy) kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- a) Ortaku themelues **Sonila Abdalli**, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 5000 (pesë mijë) Lekë, që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - b) Ortaku themelues **Bledar Këneta**, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 5000 (pesë mijë) Lekë, që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6
Administratori

- 1) Administratori i parë i shoqërisë emërohet **Bledar Këneta**, atësia Selman, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 06.12.1984, lindur në Shijak dhe banues në Tiranë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me anë të pasaportës me numër personal: I41206005V, me afat emërimi 5 vjeçar.

Neni 7
Baza Ligjore


- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 8
Mosmarrëveshjet

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.


O R T A K Ë T
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"MiA Collection" shpk

Sonila Abdalli



(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

Bledar Këneta



(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)